



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1676/2 Prot.

Durrës, më 26.9.2024

VENDIM

Nr 8 , datë 26.9 2024

PËR  
" MIRATIMIN E HIMNIT UNIK ZYRTAR TË UNIVERSITETIT  
"ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS"

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 36, neni 37, pika 1,3,4,5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit dhe të Rregullores së UAMD-së, të shkresës nr.1637 prot., datë 24.09.2024 të Grupit të punës për organizimin e Ceremonisë së Diplomimit, shkresës nr. 1637/1 prot., datë 24.09.2024 të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike, Senatit Akademik në mbledhjen e datës 26.09.2024,

VENDOSI:

1. Miratimin e Himnit unik zyrtar të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës" sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
  - Administratori,
  - Zv. Rektorët,
  - Grupi i punës për s ceremonise se diplomimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi





Senatit Akademik

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE

Nr. 1637/prot.

Durrës më 24/9/2024

Lënda: Kthim përgjigje shkresës nr. 1637 prot., datë 24.09.2024 "Propozim mbi krijimin e himnit unik zyrtar për Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës"

REKTORIT

PROF.DR. SHKËLQIM FORTUZI

KËTU

I nderuar,

Në vijim të shkresës nr. 1637 prot., datë 24.09.2024 "Propozim mbi krijimin e himnit unik zyrtar për Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës" kaluar për mendim sqarojmë si më poshtë vijon:

Duke qënë se himni unik zyrtar i propozuar përfaqëson një element të ri përbërës me karakter gjithpërfshirës, përfaqësues dhe identifikues të Universitetit i cili nga momentin e miratimit do të ketë karakter të përhershëm, do të sugjeroja që propozimi i grupit të punës t'ju kalonte për konsultim dhe miratim anëtarëve të Senatit Akademik, si dhe për të bërë sugjerimet e mundshme në lidhje me propozimin dhe me përmbajtjen e tekstit të himnit të propozuar. Me konsultimin dhe miratimin nga Senati Akademik, vlerësojmë se mund të vijohet me prezantimin e himnit në ceremoninë e diplomimit në UAMD-së.

Duke ju falënderuar,

DREJTOR/DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE

Blerina Koka



*Selektorët të shkëlqimëve  
juridike për mendimin  
ligjet.*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
GRUPI I PUNËS SË CEREMONISË SË DIPLOMIMIT

*Senati Akademik.*

Nr. 1637 prot.

Durrës, më 24/9 /2024

**Lënda:** Propozim mbi krijimin e himnit unik zyrtar për Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës.

**Drejtuar:** **PROF. DR. SHKËLQIM FORTUZI**  
**REKTOR**

*I nderuar Rektor,*

Në kuadër të Vendimit nr. 1, datë 11.09.2024, grupi i punës i përcaktuar për t'u angazhuar me organizimin e ceremonisë së diplomimit për vitin akademik 2023- 2024 në të dy ciklet e studimit, e cila do të zhvillohet ditën e premte, datë 27 Shtator 2024, ju paraqet propozimin "Mbi krijimin e një Himni Zyrtar identifikues për Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës.

Me qëllim për të forcuar identitetin, frymën e përkatësisë për studentët, stafin akademik dhe administrativ të Universitetit tonë, krijimi i një himni zyrtar do të sjellë një element të ri, të përhershëm dhe të rëndësishëm për universitetin tonë. Dhe këtë risi menduam ta prezantonim, ditën e Ceremonisë së Diplomimit, datë 27 Shtator 2024.

Për sa më sipër, kërkojmë pëlqimin tuaj paraprak dhe miratimin zyrtar nga Senati Akademik për ta prezantuar zyrtarisht himnin ditën e Ceremonisë së Diplomimit.

Bashkëlidhur kësaj shkrese, ju lutem gjeni edhe tekstin e himnit të krijuar nga një kompozitor ekspert, bazuar në virtytet dhe cilësitë e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KRYETAR**  
**Grupi i Punës së Ceremonisë së Diplomimit**

**Dr. Silvana Gashi**





# TEKSTI I HIMNIT TË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS

## *Strofa nr.1*

*Sot po trokasim në derën tënde,  
E ardhmja jonë,  
Tek ti besojmë, ikonë, simbol i të ardhmes sonë.*

*Krenar ndër vite,  
Universiteti ynë,  
Dijen kurore (A. Moisiu),  
Je madhështor!*


## *Refreni!*

*Tek ti ëndrrat  
I bëjnë dritë zemrave.  
Rrugëtuam mes dijesh,  
Të ndritur emrash, për ne!*

*Durrësi ynë,  
Horizonte të reja,  
Dyert e jetës  
I hape për ne, për ne!*

*Universiteti ynë, Aleksandër Moisiu,  
Ti je simbol, Ti je vizion,  
Je sfida jonë..  
Tek ti besojmë të ardhmen tonë.*

*Ti je simbol,  
Ti je vizion european,  
Je sfida jonë,  
Ti e ndriçon, të ardhmen tonë.*



## **Strofa nr.2**

*Tek ti trokitëm,  
Dyert hapur gjithnjë gjetëm,  
Tek ti besuam,  
Ëndërruam, realizuam.*

*Krenar gjithmonë,  
Universiteti ynë.  
Dijen kurore (A. Moisiu)  
Je madhështor!*

## **Refreni!**

*Tek ti ëndrrat  
I bëjnë dritë zemrave.  
Rrugëtuam mes dijesh  
Të ndritur emrash, për ne!*

*Durrësi ynë,  
Horizonte të reja.  
Dyert e jetës  
I hape për ne, për ne!*

*Universiteti ynë, Aleksandër Moisiu,  
Ti je simbol, Ti je vizion,  
Je sfida jonë.  
Tek ti besojmë të ardhmen tonë.*

*Ti je simbol,  
Ti je vizion european,  
Je sfida jonë,  
Ti e ndriçon, të ardhmen tonë.*